

# **ANGAZHIMI QYTETAR NË MONITORIMIN E PROCEDURAVE PUBLIKE**

Leksioni 2, Baza teorike dhe termat bazë që lidhen me procesin e prokurimit* .....	2
Leksioni 3, Rregulloret e BE-së dhe zbatimi i legjislacionit për prokurimet publike .....	5
Leksioni 4, Kuadri rregullator dhe konteksti në Bullgari dhe Shqipëri .....	7
Leksioni 5, Fusha të reja të prokurimit strategjik publik në nivel BE-je .....	9
Leksioni 6, Shembuj të nismave të shoqërisë civile dhe të praktikave të mira për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në prokurimin publik .....	13

## Leksioni 2, Baza teorike dhe termat bazë që lidhen me procesin e prokurimit\*

“**Autoritet kontraktor**” është autoriteti publik (në qeveria qendrore apo njësi e qeverisjes vendore) që kryen procedura të prokurimit publik.

**Ofertë (e njëjtë me propozim, tender, kuotim):** Përgjigja nga një furnitor, kontraktues ose ofrues shërbimi për një kërkesë (shpallje prokurimi) që, nëse rekomandohet për t’u shpallur fitues, do ta detyronte furnitorin, kontraktorin ose ofruesin e shërbimit të vepronte në përputhje me kontratën.

**Kategori prokurimi:** Ka tre kategori kryesore prokurimi: mallra, shërbime dhe punë. Për mallrat, furnitorët sigurojnë mallra (pajisje/materiale). Shërbimet janë konsulence dhe jo-konsulence, ndërsa punët janë për rehabilitimin, riparimin apo ndërtimin e infrastrukturës.

**Ent** **prokurimi**  
Organ publik i caktuar si përgjegjës për blerjen dhe dhënien e kontratave për mallra, shërbime dhe punë. Është e njëjta gjë si ‘enti prokurues’

**Kontraktor** është personi apo subjekti që kryen punë sipas një kontrate. Termi mund t’i referohet një individi apo organizate që lidh kontratë me autoritetin kontraktues për kryerjen e shërbimeve, punëve dhe lëvrimin e mallrave.

**Nënkontraktor:** Një firmë apo ent tjetër i nënkontraktuar nga ofertuesi fitues për të përmbushur një pjesë të kushteve të kontratës. Nënkontraktori në përgjithësi përgjigjet vetëm para kontraktorit që ka nënshkruar kontratën me entin e prokurimit.

**Ofertues:** Ofertues janë të gjitha subjektet fizike dhe juridike që kanë të drejtën të paraqesin ofertë për zbatimin e një kontrate të caktuar.

### **Përshkrimi i procesit të prokurimit publik dhe fushat kryesore të cenueshme nga korrupsioni**

Procesi i prokurimit zakonisht ka të bëjë me identifikimin e nevojave; me përcaktimin se cili person ose organizatë është më e mira për të plotësuar këto nevoja; dhe me sigurimin se nevoja plotësohet në vendin e duhur në kohën e duhur dhe me çmimin dhe cilësinë më të mirë. Rezultatet nga sondazhet me bizneset në Bullgari tregojnë se shumica e abuzimeve kanë të bëjnë ose me dhënien e avantazheve për një ofertues të veçantë në dokumentacionin teknik ose me shmangien e kritereve të paracaktuara të vlerësimit kur renditen ofertat në dobi të fituesit të paracaktuar.

Si fillim, *marrëdhëniet* mes personelit të sektorit publik dhe furnitorëve përbëjnë edhe bazën e korrupsionit në kuadër të prokurimit nga sektori publik. Marrëdhëniet e papajtueshme që nuk janë deklaruar që në fillim ose që menaxhohen keq shpesh çojnë në konflikte interesi (shih *Modulin për Konfliktin e Interesave* për më shumë detaje mbi këtë temë). Shpesh ofrohen pak ose aspak trajnime për konfliktet e interesit për zyrtarët e prokurimit publik dhe kontraktorët e tyre. Një shqetësim tjetër i madh është mungesa e trajnimit për politikat e prokurimit, për mashtrimin dhe korrupsionin për entet publike dhe furnitorët e sektorit publik.

Së dyti, menaxhimi i stafit të përfshirë në prokurime shpesh është i dobët. Punonjësit mund të kenë mungesë njohurish të politikave dhe procedurave të prokurimit. Kjo mund të jetë me rrezik të madh për bashkitë e vogla, të cilat kanë mangësi me ekspertë prokurimit në personelin e tyre. Menaxhimi i dobët i stafit çon në mbikëqyrje të dobët dhe kontrole të pakta ndaj atyre që janë të përfshirë në prokurimin publik. Kjo gjë sjell si rezultat korrupsion dhe krijimin e mundësive për mashtrim.

Në proceset e prokurimit publik mund të zbulohen edhe mangësi të tjera që ofrojnë mundësi për manipulime dhe mashtrime në fazat e ndryshme të këtyre proceseve.

*Faza përgatitore:* Specifikimet e dobëta teknike që çojnë në ofertuesit e favorizuar; Mungesa e pjesëmarrjes së publikut në specifikimet e projektimit/ofertimit, ofertues të paracaktuar nga specifikimi i kërkesave sipas tyre. Një rrezik që lidhet me korrupsionin këtu mund të jenë edhe afatet e shkurtra kohore. Në fazën përgatitore, imponimi i nevojave urgjente, emergjencave dhe vendimeve të shpejta mund të çojë në mospërputhjen e politikave të prokurimit dhe krijimin e mundësive të ndryshme për korrupsion.

*Faza e reklamimit (shpalljes):* reklamim i kufizuar/pamjaftueshëm; shpallja e prokurimit botohet në gazetë me tirazh të ulët; mungesa e aksesit për tek informacioni i prokurimit ndikon tek procedura e prokurimit dhe mund të lehtësojë korrupsionin në sektorin publik.

*Para-kualifikimi:* Kërkesa të njëanshme për të favorizuar një ofertues apo kontraktor, procedura të zgjata që çojnë në mundësi për ryshfet, dhe ndarje kontrate mes subjekteve konkurruese.

Ndonjëherë mund të ketë negociata të drejtpërdrejta mes zyrtarëve të prokurimit të qeverisë dhe furnitorëve, gjë që përbën një tjetër rrezik për korrupsion, veçanërisht për ofrimin e dhuratave dhe përfitimeve dhe favorizimeve në vendimet që lidhen me prokurimin.

Edhe pse praktika të tilla janë të përjashtuara në mënyrë eksplicite nga legjislacioni kombëtar dhe ai i BE-së për prokurimet, shpesh agjencitë e prokurimit përdorin kërkesa teknike për produktin ose kërkesa paraprake për ekspertizën dhe kapacitetin e ofertuesve për të ulur numrin e këtyre të fundit dhe për ta drejtuar procesin drejt rezultatit të synuar.

Ka rreziqe të konsiderueshme korrupsioni edhe në fazat e mbylljes së marrëveshjes dhe zbatimit të kontratës. Këto rreziqe lidhen kryesisht me devijimin e kushteve të kontratës nga parametrat e ofertës fituese ose shmangia e vetë zbatimit aktual nga kontrata e lidhur me entin prokurues. Para anëtarësimit të Bullgarisë në BE, anekset në kontrata shpesh përdorshin për t'u bërë të mundur furnitorëve të tërhiqeshin nga kushtet e ofertës fituese. Me përfshirjen dhe miratimin e direktivave të BE legjislacioni kombëtar e detyron tani kontraktorin që të përfshijë në kontratë të gjithë komponentët e ofertës fituese duke përjashtuar mundësitë për ndryshime të mëvonshme në të, me disa përjashtime të cilat listohen në mënyrë eksplicite në legjislacion.

Në fazën e zbatimit, përdorimi i nënkontraktorëve nga kontraktorët përbën një tjetër shqetësim dhe rrezik potencial për korrupsion. Edhe pse është kërkesë që kontraktori të ofrojë informacion të bollshëm për përfshirjen e nënkontraktorëve, shpesh nuk ndodh kështu, gjë që përbën rrezik për korrupsionin.

### **Përmbledhje e problematikës dhe abuzimeve në procesin e prokurimit publik:**

- Rreziqe nga sjelljet e gabuara dhe shkeljet që lidhen me funksionin e zyrtarëve publikë (ndikim i gabuar, konflikte interesi, abuzim me postin)

- Marrëveshje të fshehta mes zyrtarëve publikë dhe stafit dhe organizatave të sektorit privat për të mashtruar agjencinë prokuruese.
- Dhurata dhe përfitime të padrejta duke përfshirë ryshfet nga kontraktorët për zyrtarët publikë.
- Përdorim i gabuar i informacionit duke përfshirë këtu dhënien e informacionit për çmimet dhe specifikimet nga zyrtarët publikë tek kontraktorët.
- Mashtrime, ku përfshihen fatura fiktive dhe të falsifikuara.
- Njëanshmëri dhe favorizim në përzgjedhjen e furnitorëve nga zyrtarët publikë.
- Menaxhimi i dobët dhe monitorimi i pamjaftueshëm i performancës nga zyrtarët publikë.

Çfarë mund të bëjë shoqëria civile për të parandaluar dhe kontrolluar rreziqet e korrupsionit në procesin e prokurimit? Pjesa më e madhe e nismave të shoqërisë civile lidhen edhe me një formë monitorimi, me vëzhgues të pavarur (si në nismën e Paktit të Integritetit), grupe vëzhgimi, forma të ndryshme të veprimit dhe rrjeteve të bashkëpunimit, pjesëmarrje në komisionet e monitorimit dhe mbikëqyrjes bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit me qeverinë vendore, etj. Këto nisma mund të jenë: (i) me orientim nga poshtë-lart, d.m.th., nxitur dhe mbështetur nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile; (ii) me orientim nga lart-poshtë, nxitur dhe iniciuar nga qeveria; (iii) nisma me fitim të ndërsjellë, të krijuara dhe drejtuara nga qytetarët, shoqëria civile dhe vetë qeveria. Shembuj të nismave të tilla jepen në pjesët e mëposhtme të këtij moduli.

Çdo veprim apo nismë e tillë kërkon, para së gjithash, që shoqëria civile të ketë aftësitë profesionale për të realizuar këto veprime. Kjo ka të bëjë me faktin që shoqëria civile të ketë anëtarë të trajnuar të stafit, kapacitetin organizativ si dhe buxhetin e mjaftueshëm për të marrë pjesë në monitorimin e prokurimit.

Për pjesëmarrje domethënëse të qytetarëve në monitorimin e prokurimeve, është e rëndësishme që së pari të identifikohen fazat kryesore të prokurimit ku mund të bashkëpunojnë shoqëria civile dhe qeveria. Po ashtu, është shumë e rëndësishme që informacioni për proceset e prokurimit të jetë i aksesueshëm nga publiku i gjerë. Kjo do të ndihmojë që të shmanget përzgjedhja e individëve dhe organizatave të caktuara në formimin e komisioneve monitoruese ose pjesëmarrjen në dëgjesat publike. Nëse duam që çdo formë e angazhimit të shoqërisë civile të ketë efektivitet, është e rëndësishme që procesi i vendimmarrjes në nivel vendor të jetë transparent, përfshirë këtu edhe transparencën e procedurave të prokurimit. Së dyti, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët duhet të kenë akses në informacione objektive dhe të besueshme, të cilat duhet të garantohen me dispozita dhe sanksione ligjore. Këto të fundit duhet të përfshijnë edhe klauzola edhe për informatorët, në mënyrë që qytetarët të ndihen të mbrojtur në veprimet e tyre.

## Leksioni 3, Rregulloret e BE-së dhe zbatimi i legjislacionit për prokurimet publike

Objektivi kryesor i legjislacionit të BE-së për prokurimin publik (d.m.th., Direktiva e Prokurimit Publik, Direktiva e “Shërbimeve”, Direktiva që mbulon prokurimin publik në sektorët e mbrojtjes dhe të sigurisë dhe Direktiva “Riparimet”) është të sigurojë respektimin e parimeve të Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti parimet e lirisë së lëvizjes së mallrave, lirisë së krijimit dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve, si dhe parimeve të tjera që rrjedhin prej saj.

Afati i përfshirjes dhe miratimit për të tre direktivat për prokurimet publike dhe koncesionet të miratuara në 2014 ishte data 18 prill 2016. Kjo ishte data në të cilën vendet e BE-së duhet t'i kishin përfshirë këto direktiva në legjislacionin kombëtar në përputhje me direktivat. Rregullat e reja u prezantuan për të siguruar vlerë më të mirë të fondeve për blerjet publike dhe respektimin e parimeve të transparencës dhe konkurrencës. Rregullat e reja marrin parasysh tashmë edhe çështjet mjedisore dhe sociale si dhe aspektet e novacionit që duhen kihen parasysh gjatë dhënies së kontratave publike (shih seksionin për prokurimin strategjik që jepet më poshtë). Parandalimi i korrupsionit dhe krijimi i një kulture integriteti janë prioritet i Direktivave të Prokurimit Publik që hynë në fuqi më 18 prill 2016.

Deri në këtë datë, vendet anëtare të BE-së duhet të përfshijnë dhe miratojnë në legjislacionin e tyre kombëtar direktivat e mëposhtme:

- Direktiva 2014/24/EU për prokurimin publik
- Direktiva 2014/25/EU për prokurimin nga entet që veprojnë në sektorët e ujësjellësit, energjisë, transportit dhe shërbimit postar
- Direktiva 2014/23/EU për dhënien e kontratave të koncesioneve

Këto rregulla të reja thjeshtojnë procedurat e prokurimit publik dhe i bëjnë ato më fleksibël. Kjo gjë do të jetë me përfitim për autoritetet publike dhe bizneset, veçanërisht ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM). Rregullat e reja parashikojnë procedura **më të thjeshta** për autoritetet kontraktuese, kështu që ato do të mund të marrin vlerë më të mirë të fondeve publike. Së dyti, rregullat e reja do të lehtësojnë **dixhitalizimin** e mëtejshëm të prokurimit publik, gjë që do të rrisë ndjeshëm efikasitetin e sistemit të prokurimit publik dhe do të ulë në mënyrë drastike vëllimin e dokumenteve që nevojiten për përzgjedhjen e kompanive. Rregullat e reja nxisin institucionet publike të zbatojnë politika **mjedisore** si dhe politika që lidhen me integrimin social dhe inovacionin.

Direktivat e reja të Prokurimit Publik përcaktojnë masa që përmirësojnë drejtpërsëdrejti transparencën dhe luftën kundër korrupsionit. Disa nga këto masa janë:

1. **Mashtrimi dhe konflikti i interesit** – nocioni “konflikt interesi” përkufizohet në nivel BE-je për herë të parë në direktivat e reja. Përkufizimi i ri do ta bëjë më të lehtë identifikimin dhe trajtimin e rasteve të mashtrimit dhe konflikteve të interesit.

2. Aktualisht, bizneset e dënuara për mashtrim dhe korrupsion mund të përjashtohen nga procedurat e prokurimit publik. Sipas direktivave të reja, gjithsesi, **një kompani mund të përjashtohet** edhe nëse ushtron ndikim të padrejtë në procesin e vendimmarrjes ose nëse ka bërë deklarime të rreme.
3. Duke qenë se periudha për shpalljes së fituesit është tejet e cënueshme nga korrupsion, rregullat për **ndryshimin e kontratave** gjatë periudhës së tyre të zbatimit janë bërë më të qarta dhe më të thjeshta për të hequr çdo pikë dyshimi që mund të lindë për keqinterpretim.
4. Meqenëse se transparenca është një nga mënyrat më efektive për të luftuar korrupsionin dhe shkeljet në prokurimin publik, vendeve të BE-së u kërkohet të raportojnë shkeljet e rregullave tek autoritetet kombëtare, të publikojnë rezultatet e monitorimeve të tyre dhe të paraqesin **një raport tek Komisioni çdo tre vjet** për burimet më të zakonshme të shkeljeve apo pasigurisë ligjore.
5. **‘MEAT’**. Direktivat e reja i vënë theksin ““tenderit me avantazhin më të mirë ekonomik” (most economically advantageous tender’ - MEAT) si kriter fitues për kontratat me fondet publike. Si rezultat, autoritetet kontraktuese do t’u duhet gjithnjë e më shumë të vlerësojnë elementët e cilësisë gjatë vlerësimit të ofertave dhe të mos vendosin më vetëm në bazë të çmimit më të ulët.
6. **Thjeshtësimi i procedurave dhe përdorim më i madh i mjeteve elektronike** në prokurimet publike kanë po aq rëndësi në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit. Pritet që prokurimi elektronik të bëhet i detyrueshëm në BE nga viti 2018.

# Leksioni 4, Kuadri rregullator dhe konteksti në Bullgari dhe Shqipëri

## **Bullgaria**

Agjencia e Prokurimit Publik u krijua në 12.03.2004, me Dekretin Nr. 56 të Këshillit të Ministrave (shpallur me VKM Nr. 24/23.04.2004) sipas Ligjit të Prokurimit Publik që është në fuqi që nga data 01.10.2004, ligj që parashikon ngritjen e një autoriteti administrativ autonom në këtë fushë. Veprimtaria, struktura, organizimi i punës dhe numri i punonjësve të kësaj agjencie përcaktohen me Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Agjencia varet nga Ministri i Financave dhe e ndihmon atë në zbatimin e politikës kombëtare në fushën e prokurimit publik. Përparësi për Agjencinë e Prokurimit Publik është të sigurojë efektivitetin e sistemit të prokurimit publik në Bullgari në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Barazia dhe mosdiskriminimi;
- Konkurrenca e lirë;
- Proporcionaliteti;
- Përgjegjshmëria dhe transparenca.

Rregullorja e parë e procedurave të prokurimit publik në Bullgari u prezantua me Ligjin “Për dhënien e kontratave shtetërore dhe bashkiake” në vitin 1997. Dy vjet më vonë ligji u zëvendësua me Ligjin e Prokurimit Publik të vitit 1999. Pesë vjet më vonë, në përgjigje të ndryshimeve në zhvillimin ekonomik të vendit, ligji u rishikua ndjeshëm, duke hartuar ligjin që është aktualisht në fuqi. Nga miratimi i ligjit në vitin 2004 deri më sot, Ligji për Prokurimin Publik është ndryshuar plot 29 herë. Shumica e shtesave dhe ndryshimeve synonin të korrigjonin deficitet në zbatimin e saj praktik si dhe të vendosnin pengesa efikase kundër praktikave korruptive.

Raundi i fundit i amendamenteve u fillua me projekt-ligjin e ri të prezantuar nga Këshilli i Ministrave në gusht të vitit 2013. Projektligji u miratua në seancën e tij të parë në Parlament më 10 tetor 2013. Ky miratim u shoqërua me diskutime të forta nga Komisioni i Çështjeve Ligjore pas seancës së tij plenare. Më 26 shkurt 2014, projektligji u diskutua për herë të dytë. Projektligji u miratua me një numër të vogël votash.

Ligji i fundit i prokurimit publik u miratua më 30 prill 2014 dhe u shpall me botimin në Gazetën Zyrtare 40, datë 13 Maj 2014. Ndryshimet më të fundit në legjislacion synojnë të korrigjojnë mangësi të mëdha në ligj dhe janë më radikale që nga drafti i parë i ligjit. Megjithatë, në disa botime të medias shprehen shqetësimet se edhe me rishikimin e saj të fundit ligji nuk ka arritur të trajtojë dobësitë ekzistuese në sistemin e prokurimit publik.

Ligji aktual i prokurimit publik (i shpallur me Dekretin Nr. 13, datë 16 Shkurt 2016, dhe që hyri në fuqi më 15 prill 2016), ka përfshirë Direktivat e reja të Prokurimit Publik të BE-së (miratuar nga Parlamenti Evropian më 26 shkurt 2014): Direktivën 2014/24/EU për prokurimin publik të datës 26 shkurt 2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit; dhe Direktivën 2014/25/EU të datës 26 shkurtit 2014 për prokurimin nga subjektet që operojnë në sektorët e ujësjellësit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare. Ky ligj nuk përfshin dispozitat që lidhen me

koncesionet (pasi Direktiva 2014/23/EU pret që këto dispozita të jenë në një ligj të veçantë). Ligji aktual është një përpjekje për të ruajtur ekuilibrin mes rregullave të vendosura tashmë dhe atyre që Evropa tani i ka vënë në tryezë. Për sa i përket qëllimit të ligjvënësimit evropian për ta bërë më të lehtë kornizën e re të prokurimit, më fleksibël dhe më pak të rënduar, për fat të keq legjislatura bullgare përfundimisht nuk ia ka arritur ta përmbushë këtë qëllim. Ligji bullgar për prokurimet publike ka shumë struktura, është tepër kompleks dhe shumë i varur nga aktet nënligjore.

## Shqipëria

Sipas Raportit të Progresit 2013 për Shqipërinë, “prokurimi publik dhe koncesionet janë ende një nga sektorët kryesorë në të cilët Kontrolli i Lartë i Shtetit ka gjetur shkelje financiare.” Raporti i vitit 2016 pranon se “mbetet e një rëndësie të madhe rritja e transparencës dhe llogaridhënies, veçanërisht nëpërmjet sigurimit të funksionimit efektiv, efikas dhe transparent të sistemit të prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike. Shqipëria ka vazhduar të respektojë plotësisht të gjitha pozicionet dhe deklaratat e përbashkëta të politikës së jashtme dhe të sigurisë së BE-së.” Përsa i përket luftës kundër korrupsionit, raporti thekson se korrupsioni vazhdon të jetë një “problem serioz” dhe se nevojiten “hetimet proaktive, vlerësime sistematike të rrezikut dhe bashkëpunimi ndërinstitucional” për të luftuar korrupsionin në mënyrë efektive.

Si pjesë e procesit të zgjerimit, vendet candidate duhet të harmonizojnë legjislacionin e tyre me kërkesat e ligjit të BE-së, duke përfshirë Direktivat e Prokurimeve Publike. Kështu, sistemi i prokurimit i vendeve candidate duhet të jetë në përputhje me standardet e shteteve anëtare. Qëllimi është të ketë legjislacion të qartë dhe transparent të prokurimit publik, zbatim efikas të prokurimit elektronik dhe autoritetet kompetente kontraktuese. Pavarësisht përpjekjeve të bëra deri më tani, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar prokurimin elektronik me *acquis* të BE-së dhe të vazhdojë të pakësojë procedurat jo-konkurrese dhe jo-transparente.

Në fillim të vitit 2009 Shqipëria u bë një nga vendet e para në mbarë botën që kishte një sistem të detyrueshëm të prokurimit elektronik për të gjitha prokurimet publike me vlerë mbi 3500 euro. Që nga ngritja e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, aplikimi me rrugë elektronike shihet si një nga arritjet më të mëdha. Raporte të ndryshme pas kësaj kanë theksuar përfitimet kryesore të sistemit të prokurimit elektronik, për shembull, me eliminimin e ndërveprimit të drejtpërdrejtë njerëzor në procesin e paraqitjes së ofertave, monitorimin efikas të punës dhe shërbimeve nga qeveria, përmirësimin e komunikimit mes furnitorëve, shitësve dhe qytetarëve, përmes sistemit online, dhe zvogëlimin të punës burokratike.



## Leksioni 5, Fusha të reja të prokurimit strategjik publik në nivel BE-je

Në rregulloret e reja të BE-së për prokurimet publike parashikohet zbatimi aktiv dhe integrimi i çështjeve *të gjelbra, atyre sociale dhe inovacionit* në politikën e prokurimit publik.

Komisioni Evropian e përkufizon *prokurimin e gjelbër publik (PGP)* në komunikimin e tij (COM (2008) 400) “Prokurimi publik për një mjedis më të mirë” si “një proces me anë të të cilit autoritetet publike kërkojnë të blejnë mallra, shërbime dhe punë me ndikim të reduktuar në mjedis.” Prokurimi i qëndrueshëm merr në konsideratë pasojat mjedisore, sociale dhe ekonomike të projekteve, materialeve të përdorura, metodave të prodhimit, logjistikës, dhe asgjësimit të mallrave që janë prokuruar.

*Prokurimi publik me përgjegjshmëri sociale (PPPS)* përfshin aspektet sociale në vendimin për blerje nga autoriteti publik. Për shembull, mundësitë për punësim, punë të denjë, respektim i të drejtave sociale dhe të punës, përfshirja sociale (përfshirë këtu edhe personat me aftësi të kufizuara), mundësi të barabarta, aksesueshmëri dhe projektim për të gjithë, duke marrë parasysh kriteret e qëndrueshmërisë, çështjet e tregtisë etike dhe respektim më të mirë të përgjegjësive sociale të biznesit me vullnetin e këtij të fundit.

*Prokurimi publik novator (PPN) ose prokurimi publik i zgjidhjeve novatore* i referohet autoritetit kontraktues për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve novatore që ende nuk janë të disponueshme në treg në masë të gjerë. Për më tepër, në vitet e ardhshme, direktivat e reja për prokurimin publik do të ndihmojnë në nxitjen e prokurimit publik novator duke inkurajuar autoritetet kontraktuese që të zhvillojnë procese tenderimi që nxisin risitë dhe në këtë mënyrë të mbështesin bizneset për të zhvilluar kapacitetin e tyre për novacione duke garantuar kushtet bazë të konkurrencës, transparencës dhe trajtimit të barabartë.

Prokurimi etik (që shpesh referohet edhe si prokurimi i përgjegjshëm) i referohet proceseve të prokurimit që: 1) respektojnë standardet bazë ndërkombëtare kundër sjelljes kriminale (si ryshfeti, korrupsioni dhe mashtrimet) dhe abuzimi me të drejtat e njeriut (si skllavëria moderne) dhe marrin menjëherë masa për trajtimin e tyre kurdoherë që zbulohen raste të tilla, dhe 2) sjellin si rezultat përmirësime në jetën e njerëzve që kontribuojnë në zinxhirët e furnizimit dhe që ndikohen nga vendimet e zinxhirit të furnizimit.

### **Përmirësimi i integritetit në prokurimin publik**

Çfarë mund të bëjnë qeveritë dhe shoqëria civile për të siguruar që ligjet e reja për prokurimin publik të zbatohen në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, duke siguruar që paratë e taksapaguesve të shpenzohen në dobi të shoqërisë? Për të zvogëluar rreziqet e korrupsionit në sistemin e prokurimit publik, organet publike dhe të gjithë aktorët e prokurimit publik (kontraktorët, furnitorët, ofruesit e shërbimeve dhe publiku i gjerë) në nivel vendor dhe qendror duhet t'i përmbahen disa parimeve kryesore të qeverisjes së mirë dhe integritetit (Shih për më shumë detaje modulet mbi qeverisjen e mirë dhe infrastrukturën e etikës).

Kuadri procedural e prokurimit publik duhet të zhvillohet duke ndjekur parimet e *transparencës, trajtimit të barabartë pa diskriminim, konkurrencës së ndershme, përgjegjshmërisë dhe hapjes ndaj publikut*. Këto parime rrisin integritetin në prokurimin publik dhe në këtë mënyrë edhe besimin e qytetarëve tek qeveria. Transparenca dhe hapja kërkojnë që informacioni për procesin e prokurimit publik të vihet në dispozicion të të gjithë aktorëve në procesin e prokurimit. Sigurimi i informacionit dhe transparencës në të gjithë ciklin e prokurimit do të mundësojë trajtimin e drejtë dhe të barabartë për furnitorët e mundshëm. Mekanizmat e përgjegjshmërisë për prokurimin publik mund të iniciohen dhe përkrahen si nga qeveria ashtu edhe nga qytetarët. Disa nga mjetet më të përdorura janë: *buxhetimi me pjesëmarrje, transferimi i shpenzimeve publike, monitorimi nga qytetarët dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimeve publike, punëve dhe mallrave*. Sipas udhëzimeve të PNUD-it për zhvillimin e kapaciteteve në prokurimin publik, rritja e përgjegjshmërisë mund të arrihet duke angazhuar shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë nëpërmjet mekanizmave të pavarur të shqyrtimit, nxjerrjes së informacionit dhe prezantimit të sistemeve përkatëse të monitorimit me pjesëmarrje. Në këtë drejtim luajnë një rol të rëndësishëm mekanizmat e transparencës, të tilla si mbikëqyrja publike dhe monitorimi.

Siç theksohet edhe nga OECD (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) në botimin e saj “Parimet për Integritetin në Prokurimin Publik”, “qeverisja e dobët në prokurimin publik pengon konkurrencën në treg dhe ngre çmimin e paguar nga administrata për mallra dhe shërbime, duke ndikuar drejtpërdrejtë në shpenzimet publike dhe rrjedhimisht edhe tek burimet e tatimpaguesve.” Dhjetë parimet theksojnë se përpjekjet për të përmirësuar vlerën e fondeve publike në prokurimin publik duhet të shoqërohen me masat për rritjen e transparencës, promovimin e praktikave të mira të menaxhimit, parandalimin e mbetjeve dhe shkeljeve dhe forcimin e përgjegjshmërisë dhe kontrollit nga jashtë.

### **Mekanizmat e transparencës dhe përgjegjshmërisë për parandalimin dhe uljen e korrupsionit në prokurimet publike**

Për të parandaluar korrupsionin në prokurimin publik, organet publike mund të marrin masa parandaluese dhe të krijojnë mekanizma llogaridhënieje dhe monitorimi. Sistemet e prokurimit duhet të pajisen me struktura të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm, mekanizmat e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe me mbrojtjen efektive të informatorëve. Edhe prokurimi publik duhet të shqyrtohet nga aktorë të tjerë të interesit, si shoqëria civile, media, publiku etj., nëpërmjet kontrollit shoqëror.

Përsa i përket rritjes së transparencës dhe hapjes ndaj publikut, organet publike mund të rrisin ndërgjegjësimin në lidhje me rregullat mes të gjithë aktorëve të prokurimit publik, në mënyrë që të sigurohemi që rregullat të respektohen nga secili prej këtyre aktorëve. Një hap i dytë mund të jetë nxitja e një kulture integriteti në shërbimin publik dhe tek bizneset (përmes programeve të respektimit të ligjeve, përdorimit të pakteve të integritetit, forcimit të mbrojtjes së informatorëve). Përveç kësaj, organet publike mund të përqendrojnë përpjekjet e tyre për mbledhjen dhe analizim më të mirë të të dhënave për prokurimin, për shembull, duke krijuar regjistrat e kontratave për kontratat e prokurimit publik, krijimin e bazës së të dhënave për parregullsitë në prokurimin publik, zhvillimin e mjeteve të paralajmërimit paraprak, etj.

Strukturat e kontrollit të brendshëm mund të përforcohen nga inspektimet dhe zbatimi i sanksioneve administrative ose penale. Shenjat flagrante, listat e kontrollit apo treguesit shpesh përdoren nga profesionistët e prokurimit si mjet për të identifikuar problemet e mundshme në

lidhje me qeverisjen, konfliktet e interesit dhe korrupsionin në dhënien e kontratave qeveritare publike. Shenja të tilla paralajmëruese ekzistojnë për të gjitha fazat e ciklit të prokurimit. Banka Botërore hartoi një listë të shenjave flagrante që u përfundua nga Manuali i Transparency International.

Sistemi paralajmërues i shenjave flagrante mund të përdoret për qëllime të ndryshme. Para së gjithash, ky sistem ndihmon në parashikimin e korrupsionit dhe rreziqeve të tjera në lidhje me procedurat e prokurimit publik individual, kështu që duhet të theksohet funksioni i tij parandalues. Duke u mbështetur në përfshirjen e sa më shumë të dhënave të strukturuar që vihen në dispozicion, ky sistem bën të mundur analizën dhe vlerësimin e autoriteteve kontraktuese, tenderuesve ose praktikave specifike të prokurimit publik, identifikimin e pikave të dobëta dhe zonave veçanërisht të cënueshme në ciklin e prokurimit. Dhjetë shenjat flagrante më të zakonshëm të mashtrimit dhe korrupsionit në proceset e prokurimit përfshijnë (sipas Bankës Botërore, 2009) janë:

- Ankesa nga ofertues dhe aktorë të tjerë janë një burim jetik informacioni, pasi shumë hetime çojnë në zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit.
- Kontratat e shumëfishta nën pragun e prokurimit mund të nxjerrin në pah skema të ndarjes së kontratave, skema që përdoren nga keqbërësit për të shmangur kontrollin nga një nivel më i lartë ose për të shmangur ofertat konkurruese.
- Forma të pazakonta oferte, si fryrje të pashpjegueshme të çmimeve të ofertës, shifra të rumbullakosura ose të pazakonta, rotacioni i dukshëm i ofertuesve fitues, etj., mund të tregojnë marrëveshje të fshehta mes ofertuesve.
- Tarifat të fryra të dukshme për agjentët mund të përdoren për të fshehur pagesa korruptive, si për shembull përfshirja e një ndërmjetësi të panevojshëm.
- Ofertuesit e dyshimtë mund të krijojnë kompani fiktive ose firma konsulence për të marrë kontratën ose një ofertues fiktiv mund të paraqesë oferta më të larta të çmimeve për të dhënë idenë e rreme se tenderi po bëhet me konkurrencë.
- Nuk jepet arsytim pse nuk është zgjedhur oferta më e ulët, gjë që mund të tregojë manipulimin e ofertave me zyrtarë të projektit që kanë interesa të fshehta me një kontraktor të caktuar.
- Dhënie e padrejtë dhe/ose e përsëritur e kontratës pa konkurrim duhet të shqyrtohet me kujdes, veçanërisht kur këto kërkesa bëhen për arsye emergjence.
- Ndryshimet e kushteve dhe vlerës së kontratës për sa i përket çmimit, sasisë, apo llojit të shërbimeve mes përzgjedhjes dhe nënshkrimit të kontratës duhet të shqyrtohen me kujdesin më të madh.
- Urdhra të shumtë për ndryshim kontrate pas nënshkrimit të kontratës tregojnë për marrëveshje të fshehtë mes klientit dhe kontraktorit për të rritur vlerën e kontratës pa lëvrime të produkteve apo shërbimeve të tjera shtesë.
- Cilësia e dobët ose mallra të palëvruara apo shërbime apo punë të përealizuara janë tregues i qartë i mashtrimit dhe korrupsionit.

Ndër masat e tjera të kontrollit mund të jenë edhe krijimi i listës së bardhë dhe i statusin të furnitorit të preferuar. Respektimi i standardeve të antikorrupsionit dhe rritja proaktive e integritetit dhe përgjegjshmërisë mund t'u sigurojë kompanive “status e furnitorit të preferuar”, t'u mundësojë atyre akses në procese të caktuara të prokurimit që janë të hapura vetëm për kompanitë që kanë etike, t'i fusë ato në “listën e bardhë”. etj.

Mbikëqyrja nga shoqëria civile ose media i proceseve të prokurimit mund të rrisë transparencën nga ana e kërkesës. Nga ana e ofertës, po përdoren gjithnjë e më shumë teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit (TIK) për të siguruar transparencën në fazën e tenderimit të ciklit të prokurimit. Prokurimi elektronik (**e-prokurimi**) i referohet përdorimit të komunikimeve elektronike nga institucionet e sektorit publik kur blejnë mallra dhe shërbime ose kur tenderojnë punë publike. Kjo praktikë e re ka një sërë përfitimesh potenciale si për procesin ashtu edhe për transparencën. Nga ana tjetër, kjo praktikë mund të ulë shpenzimet administrative, të përshpejtojë procesin, të rrisë transparencën, të lehtësojë monitorimin, të inkurajojë konkurrencën ndërkufitare dhe të mbështesë zhvillimin e një administrate të centralizuar prokurimi. Prokurimi elektronik mund të ofrojë një burim të ri për rritjen ekonomike dhe hapjen e vendeve të reja të punës, përfshirë këtu lehtësimin e aksesit tek kontratat e prokurimit publik për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Siç u përmend më lart, prokurimi elektronik do të bëhet i detyrueshëm për vendet anëtare të BE-së deri në vitin 2018.

Raportimi në internet: OECD inkurajon qeveritë të përdorin raportimin në internet për të rritur transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut për performancën e kontratës pas nënshkrimit të saj. Kjo mund të bëhet përmes një faqeje të centralizuar interneti që ofron informacion për situatën e performancës financiare dhe jofinanciare të paketave të prokurimit nëpërmjet informacionit cilësor dhe sasior.

Baza e të dhënave ditore elektronike për tenderët, versioni në internet i “Shtojcës për Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian”, përditësohet rregullisht me tenderë nga e gjithë Evropa. Njoftimet për kontrata dhe njoftimet për shpallje fituesish mbi pragun e përcaktuar në Direktivat e Prokurimit Publik botohen në këtë bazë të dhënash.

#### Kontraktimi i hapur

Në kontraktimin e hapur përfshihet botimi dhe përdorimi i informacionit të hapur dhe të aksesueshëm dhe të përditësuar për kontratat e lidhura nga qeveria me qëllim angazhimin e qytetarëve dhe bizneseve në identifikimin dhe ndreqjen e problemeve.

Kontraktimi i hapur shkon përtej prokurimit të mallrave dhe shërbimeve, duke mbuluar lloje të tjera kontratash publike, të tilla si koncesionet dhe licencat. Kontratat e hapura po nxiten nga një numër përherë e më i madh nismash ndërkombëtare me shumë aktorë, gjë që kuptohet si rritje transparence dhe siguri i informacionit dhe mundësive të barabarta për pjesëmarrje për të gjithë ofertuesit, si mjet për uljen e mundësive për sjellje korruptive në dhënien e kontratave, punëve dhe licencave publike.

## Leksioni 6, Shembuj të nismave të shoqërisë civile dhe të praktikave të mira për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në prokurimin publik

Shoqëria civile dhe mediat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit për prokurimet publike dhe fusha të tjera të menaxhimit financiar publik. Organizatat e shoqërisë civile mund të monitorojnë materialet publike, të ushtrojnë presion ndaj qeverisë për të publikuar të dhëna të caktuara, siç janë informacionet për vlerësimin e ofertave dhe çmimeve, si dhe mund të monitorojnë drejtpërdrejtë edhe procesin e prokurimit. Në monitorimin dhe mbikëqyrjen e prokurimeve publike roli i “rojtarit” shpesh lidhet me median. Shumë skandale me prokurimet janë zbuluar nga media, ndaj edhe shtypi i lirë dhe i pavarur është një mjet i fuqishëm për promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në prokurimin publik.

Në pjesët e mëposhtme përshkruhen disa nisma të shoqërisë civile dhe komuniteteve vendore që kanë për qëllim parandalimin e korrupsionit dhe monitorimin e procesit të prokurimit publik. Disa prej tyre janë zbatuar nga organizata të mëdha ndërkombëtare (si Transparency International) ose organizata të vogla të shoqërisë civile me mbështetjen e qeverive vendore dhe grupeve të qytetarëve. Me këto nisma mund të trajtohen faza të ndryshme të procesit të prokurimit, në varësi të problemeve më serioze dhe më tipike në bashkinë dhe qytetin e caktuar. Ekzistojnë mënyra të shumta me anë të të cilave njësitë e qeverisjes vendore dhe organizatat e shoqërisë civile mund të punojnë së bashku për të siguruar respektimin dhe vazhdimin e standardeve të integritetit dhe parandalimin dhe sanksionimin e praktikave korruptive në mënyrë sa më efektive dhe menjëherë. Ky bashkëpunim mund të marrë forma të ndryshme në nivele të ndryshme, të tilla si duke punuar me agjencitë mbikëqyrëse të qeverisë për të monitoruar proceset e prokurimit, duke identifikuar mangësitë në rregulloret dhe bërë përpjekje për ndërmarrjen e reformave në fushën e prokurimit, duke trajnuar komunitetet për monitorimin e zbatimit të projekteve, etj.

Këtu duhet thënë një fjalë këshille: prokurimi është një nga çështjet që shkakton shqetësime më serioze dhe kërkon marrjen e një game të gjerë masash për të kufizuar mundësitë për korrupsion dhe ndikimin negativ në funksionimin e institucioneve dhe në mjedisin e biznesit. Organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë shumë të kujdesshëm në vendosjen e mekanizmave që duhet të përdorin nëse do të duan të bashkëpunojnë me qeverinë vendore në monitorimin e prokurimit publik. Rreziqet e tilla për shembull mund të lidhen me krijimin e partneriteteve publike-private dhe format e bashkëpunimit ndërmjet organeve publike dhe OJQ-ve, kapjen e shoqërisë civile nga politikanët në nivel vendor dhe kombëtar (p.sh., kryetarë bashkish dhe zyrtarë publikë që bëhen anëtarë të bordeve të OJQ-ve dhe që i përdorin këto organizata për përfitimet e tyre) dhe natyrën e aktiviteteve tregtare të kryera nga organizatat jofitimprurëse.

### **Manuali me teknikat e prokurimit nga OECD**

Manuali që ka të bëjë me teknikat e prokurimit publik është një burim online që mbledh zgjidhjet më të mira për parandalimin e korrupsionit, të cilat përmirësojnë teknikat aktuale të menaxhimit në procedurat e prokurimit publik në vendet anëtare të OECD-së si dhe në vende të tjera. Këto

teknika mund të përdoren gjatë gjithë ciklit të prokurimit, gjatë ofrimit të ofertave dhe fazës së tenderimit, disa prej të cilave përshkruhen më poshtë. Pjesa më e madhe e teknikave dhe stimujve të hartuara për prokurimin publik mund të përdoren edhe për dhënien e kontratave të tjera publike, siç janë koncesionet dhe licencat, duke qenë se ato përgjithësisht jepen përmes tenderëve publikë. Ky manual i OECD-së mund të gjendet në këtë adresë:

<http://www.oecd.org/governance/procurement/toolbox/indexoftoolsbyprocurementcycle.htm>

## **Paktet e integritetit**

Pakti i Integritetit në procedurat e prokurimit publik është një mjet për parandalimin e korrupsionit dhe menaxhimin jo-transparent të fondeve publike. Pakti u zhvillua nga lëvizja globale kundër korrupsionit, Transparency International. Pakti përfaqëson një kontratë me shkrim mes një autoriteti kontraktues dhe ofertuesve në procedurën e dhënies së prokurimeve publike. Ai ofron mundësinë e monitorimit të pavarur qytetar, të kryer nga një vëzhgues i jashtëm i pavarur. Pakti i Integritetit funksionon me sukses në ekonomitë kryesore si Gjermania, Italia dhe Britania e Madhe, si dhe në vendet në zhvillim apo në vendet me ekonomi në lindje si Letonia, Argjentina, Kolumbia, Ekuadori, Indonezia, Pakistani, etj. Pakti është prezantuar në 15 vende të botës dhe modelet e tij po përmirësohen vazhdimisht në bazë të kontributit dhe mendimeve e rekomandimeve nga një gamë e gjerë individësh dhe organizatash. Edhe pse ekzistojnë modele të ndryshme të Paktit të Integritetit të krijuar tashmë, të testuar në kohë, të vërtetuar si efektivë dhe që funksionojnë mirë, këto modele nuk aplikohen mekanikisht në çdo vend. Modelet e Paktit të Integritetit përshtaten sipas karakteristikave të ekonomisë dhe ligjet për procedurat e prokurimit publik në vendin përkatës, me qëllim që të sigurohet zbatueshmëria dhe efikasiteti i paktit. Vlerësimi global nga përvoja e vendeve të ndryshme, që kanë zbatuar Paktin, tregon se koncepti i tij mund të jetë shumë efektiv. Një nga aspektet pozitive të konceptit të Paktit lidhet pikërisht me faktin se ai është mjaft fleksibël për t'u përshtatur jo vetëm me legjislacionin dhe kërkesat e ndryshme e vendit zbatues, por edhe me nivelin e vullnetit të institucioneve publike për të adoptuar një qasje të ngjashme.

Më poshtë jepet një shembull i një udhëzuesi praktik për njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqatat e shoqërisë civile, ku përshkruhen problemet më të zakonshme në administrimin e fondeve publike, përfshirë këtu edhe prokurimin publik, si dhe veprimet që duhet të ndërmerren për trajtimin e këtyre problemeve.

*Burimi: Plani i veprimit anti-korrupsion: Nevoja Sociale dhe Ekonomike për Kosovën, Tetor 2006*

## **Raste të zgjedhura**

### **RASTI 1: Zbatimi i Paktit të Integritetit në Bullgari**

Modeli bullgar i Paktit të Integritetit u hartua nga Transparency International – Bullgari bazuar në vlerësimet e shumta të ekspertëve, vëzhgimeve sociologjike, analizave të legjislacionit kombëtar, studimeve krahasuese dhe kërkimeve për ekspertizën ndërkombëtare në procedurat e prokurimit publik, koncesionet dhe privatizimet.

Ai është përpunuar në përputhje me legjislacionin bullgar dhe përbën një instrument shtesë për rritjen e transparencës dhe integritetit në një nga fushat më problematike të qeverisjes - dhënien dhe zbatimin e prokurimit publik. Zbatimi i paktit të integritetit në prokurimin publik kontribuon në:

- rritjen e transparencës dhe integritetit të tenderëve;
- nxitjen e bashkëpunimit mes administratës publike dhe biznesit;
- njoftimin dhe identifikimin në kohë i sfidave të mundshme;
- kontrollin efikas qytetar për performancën e tenderuesve dhe kontraktorit të prokurimit publik;
- kontrollin efikas qytetar për performancën e autoritetit kontraktues;
- modernizimin e administratës publike;
- nxitjen e integritetit dhe standardeve etike tek bizneset.

Palët e përfshira në Paktin e Integritetit janë si më poshtë:

**AUTORITETI KONTRAKTUES** në Paktin e Integritetit është një autoritet publik (në qeverinë qendrore ose vendore), i cili zhvillon procedurën e prokurimit publik. Detyrimet e Autoritetit Kontraktues lidhen me ofrimin e informacionit tek Vëzhguesin e Pavarur në lidhje me përgatitjen dhe zhvillimin e tenderit si dhe për zbatimin e kontratës.

**OFERTUESIT** janë pala tjetër në Paktin e Integritetit. Ofertuesit (tenderuesit) janë të gjithë personat fizikë ose juridikë që kanë të drejtë të japin oferta për zbatimin e një kontrate të caktuar. Duke u bërë pjesë e Paktit, ofertuesit shprehin angazhimin e tyre për të ndjekur rregullat dhe procedurat për etikën e biznesit, për të mos shkelur parimet e konkurrencës së ndershme dhe për t'i vënë në dispozicion Vëzhguesit të Pavarur dokumente dhe informacione, të cilat lidhen me pjesëmarrjen e tyre në prokurimin publik dhe, nëse shpallen fitues të kontratës, zbatimit të kësaj kontrate.

**VËZHguesi I PAVARUR** është pala e tretë e Paktit të Integritetit, i cili nuk ka interes të drejtpërdrejtë në ndarjen e fondeve publike. Vëzhguesi duhet të jetë një organizatë e pavarur joqeveritare që gëzon reputacion të mirë dhe ka ekspertizë profesionale për kryerjen e monitorimit të pavarur civil.

Parimet kryesore të veprimtarisë së Vëzhguesit të Pavarur janë profesionalizmi, integriteti dhe paanshmëria. Vëzhguesi vëzhgon të gjitha fazat e tenderit, që janë faza përgatitore, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave dhe procedura kontraktuese si dhe zbatimi i kontratës. Vëzhguesi bën të mundur bërjen publike të procesit duke bërë të njohura gjetjet e tij.

Pakti i Integritetit në Bullgari është i hapur për të gjithë ofertuesit e një tenderi të caktuar. Aderimi në Paktin e Integritetit është vullnetar.

Transparency International - Bullgari kryen funksionin e saj të monitorimit në bazë të një Pakti të Integritetit që zakonisht bazohet në marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar më parë ose memorandum mirëkuptimi me autoritetin përkatës kontraktues. Një marrëveshje e tillë është hartuar për të siguruar bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe transferimin e ekspertizës ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Vëzhguesit.

Zbatimi pilot i Pakteve të Integritetit në Bullgari u bë në vitet 2012-2014. Aktualisht Transparency International - Bullgari është Vëzhgues i Pavarur në procedurën e prokurimit publik për projektimin dhe ndërtimin e tunelit Zheleznitza në Lotin 3.1 të Autostradës Struma.

\*\*\*\*\*

## **RASTI 2: SLLOVAKIA**

Transparency International –Sllovaki tani mirëmban një portal shumë të dobishëm në internet, të quajtur “Prokurimi i hapur publik”, të krijuar nga të dhënat e prokurimit që janë marrë dhe strukturuar (me kosto jo të vogël) nga burimet publike. Të dhënat gjenden në internet në një formë lehtësisht të kuptueshme, gjë që ka ndryshuar mënyrën se si nxirren në dritën e diellit tenderët e dyshimtë. Para reformave, informatorët u jepnin informacione gazetarëve ose vëzhguesve për procedura të dyshimta. Gazetarët ose vëzhguesit më pas dërgonin kërkesa për informacion sipas ligjit për të drejtën e informimit. Korrupsioni mund të demaskohet vetëm nga brenda: “dikujt do t’i duhet të dijë se diçka e keqe po ndodhte dhe të përpiqej ta merrte atë informacion nga organi publik.” Tani është e mundur që gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile të monitorojnë në mënyrë proaktive prokurimet dhe të nxjerrin në pah raste të dyshimta.

\*\*\*\*\*

## **RASTI 3: PËRFSHIRJA E SHOQËRISË CIVILE CIVIL NË PROKURIMIN PUBLIK, ISHUJT FILIPINE**

Ligji që rregullon prokurimin publik në Filipine u miratua në vitin 2003. Ndër rezultatet e ligjit si dhe akteve nënligjore dhe rregulloreve të tij janë standardizimi i prokurimit në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe krijimi i Bordit të Politikave të Prokurimit Publik (GPPB) (ADB/OECD 2006: 93).

Në ligjin e prokurimit përfshihen mekanizma të ndryshme për shmangien e korrupsionit në prokurimin publik. Një nga këto mekanizma është mbikëqyrja nga shoqëria civile e procesit të prokurimit: “Organizatat e shoqërisë civile lejohen të mbikëqyrin të gjitha fazat e procesit të prokurimit. Për këta përfaqësues të shoqërisë civile zhvillohen trajnime të veçanta për të forcuar aftësitë e tyre për të monitoruar aktivitetet e prokurimit publik.” (ADB/OECD 2006: 94).

Në monitorimin e prokurimit publik nga ana e shoqërisë civile prania faktike, edhe pse pa ndikim formal, e shoqërisë civile në komisionet e prokurimit nuk haset zakonisht. Megjithatë, Filipinet kanë një histori të një shoqërie civile shumë aktive të përfshirë në rrëzimin e dy presidentëve në detyrë gjatë tre dekadave të fundit dhe “perceptohet si aktore kryesore për kapërcimin e hendekut mes qeverisë dhe qytetarëve.” (Pimentel 2005: 37) .

Funksioni i mbikëqyrjes i shoqërisë civile ka çuar në procese më transparente të prokurimit dhe forcimin e respektimit të ligjit nga zyrtarë të prokurimit. Sidoqoftë, vëmendja e vëzhguesve mbi respektimin e ligjit ka nxjerrë në pah edhe një çështje të vështirë që mund të krijojë konflikte mes komisionit të vlerësimit dhe vëzhguesve. Si pasojë, Bordi i Politikave të Prokurimit Publik në Filipine po ndjek tashmë një sistem ku vëzhguesit duhet të përqendrohen më shumë në



ecurinë e procesit të prokurimit. Kjo do të harmonizojë më mirë qëllimin e komisioneve të vlerësimit dhe vëzhguesve dhe do të mundësojë shmangien e konflikteve (GPPB, pyetësi nga seminari i PCDC në Manila në tetor 2008 dhe konsultimet e mëvonshme në 2009). Burimi: UNDP

\*\*\*\*\*

#### **RASTI 4: DHJETË ORGANIZATA TAKOHEN NË TIRANË PËR PERSPEKTIVËN E STANDARDEVE TË KONTRATAVE TË HAPURA NË RAJON**

Instituti Shqiptar i Shkencave po realizon në Shqipëri një projekt që fokusohet në kontratat e hapura publike. Në qershor të vitit 2016, dhjetë organizata nga rajoni morën pjesë në një seminar të organizuar nga ky institut për monitorimin qytetar të prokurimeve publike. Pjesëmarrësit analizuan sa transparente janë të dhënat nga katër fazat e ndryshme të kontratave publike dhe prezantuan shembuj të monitorimit të prokurimit publik në Shqipëri, Bosnje Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Rumani dhe Serbi. Në këtë seminar u prezantua edhe Partneriteti për Kontrata të Hapura si një përpjekje për “marrëveshjen e qeverisë më të ndriçuar”: kurse para dhe kohë, përmirëso ofrimin e shërbimit, nxit integritetin, dhe krijo një mjedis të ndershëm biznesi.

Burimi: <http://ais.al/new/en/10-organizations-meet-in-tirana-on-the-perspective-of-open-contracting-standards-in-the-region/>

\*\*\*\*\*

#### **RASTI 5. AVOKATI I PROKURIMEVE NË KANADA**

Avokati i Prokurimit u krijua në vitin 2008 për të rritur efektivitetin dhe transparencën e praktikave të biznesit në lidhje me prokurimin. Kjo ishte pjesë e një sërë reformash për të zbatuar Planin e Veprimit për Përgjegjësitë Federale në mënyrë që të ndihmonte në forcimin e llogaridhënies dhe rritjen e transparencës dhe mbikëqyrjes në veprimtarinë e qeverisë federale.

Qëllimi i përgjithshëm i Zyrës së Avokatit të Prokurimit është të promovojë ndershmërinë, hapjen ndaj publikut dhe transparencën në prokurimet e qeverisë federale. Mandati dhe roli i tij janë si më poshtë:

1. Të shqyrtojë praktikën e departamenteve për blerjen e materialeve dhe shërbimeve me qëllim vlerësimin e ndershmërisë, hapjes dhe transparencën së tyre dhe të japë rekomandimet e duhura për departamentin përkatës.
2. Të shqyrtojë çdo ankesë në lidhje me administrimin e një kontrate për blerjen e materialeve ose shërbimeve nga një departament ose agjenci, pavarësisht nga vlera e blerjes.
3. Të mundësojë një proces alternativ të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, nëse të gjitha palët në kontratë bien dakord të marrin pjesë.

Procesi i zbatimit

Avokati i Prokurimit u krijua nëpërmjet një ndryshimi në Aktin për Departamentin e Punëve Publike dhe Shërbimeve Qeveritare, i cili krijoi autoritetin dhe aktivitetet e Avokatit të Prokurimit. Rregulloret e lidhura me Avokatin e Prokurimit, të cilat ofrojnë specifika se si duhet ushtruar autoriteti i këtij institucioni, u hartuan përmes një procesi konsultativ dhe të shpallur paraprakisht në Gazetën Zyrtare të Kanadasë, Pjesa I, në dhjetor 2007. Komentet nga shoqatat e industrisë, departamentet qeveritare dhe Përfaqësuesi i Avokatit të Prokurimit u morën në konsideratë para se të miratohej vetë rregullorja dhe zyra u bë plotësisht funksionale në maj të vitit 2008. Avokati i Popullit i raporton drejtpërdrejt Ministrit të Punëve Publike dhe Shërbimeve Qeveritare të Kanadasë. Këtij të fundit i kërkohet të paraqesë një raport vjetor në Parlamentin e Kanadasë. Edhe pse është një organizatë e pavarur nga Federata nën portofolin e Ministrit të Punëve Publike dhe Shërbimeve Qeveritare, Zyra e Avokatit të Prokurimit ka një mandat të gjerë në nivel qeverie dhe funksionon horizontalisht në departamente dhe agjenci, duke përfshirë edhe vetë Ministrinë e Punëve Publike dhe Shërbimeve Qeveritare.

#### Ndikimi dhe monitorimi

Që prej muajit maj 2008 deri në mars 2011, Zyra e Avokatit të Prokurimit ka trajtuar më shumë se 1,200 kërkesa dhe ankesa dhe ka kryer 6 hetime për çështje që lidhen me dhënien e kontratave. Zyra ka trajtuar 21 kërkesa për një proces alternativ të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për mosmarrëveshjet kontraktuale dhe ka kryer 12 shqyrtime të praktikave të prokurimit ku përfshihen 26 departamente dhe agjenci të ndryshme federale. Nga Zyra u krye një vlerësim formues (<http://opo-bca.gc.ca/autresrapports-otherreports/evalform-formevaleng.html>) nga i cili u evidentuan rezultatet e mëposhtme:

- 1) Zyra luan një rol vendimtar në ruajtjen e besueshmërisë dhe paanshmërisë së procesit të prokurimit në qeverinë federale.
- 2) Nga ofrimi i shërbimeve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga Zyra është bërë e mundur të lehtësohen zgjidhjet e mosmarrëveshjeve kontraktuale në pothuajse të gjitha instancat; Zyra konsiderohet nga furnitorët si një palë e pavarur për të siguruar drejtësi dhe për të shmangur abuzimet në prokurimin federal, si dhe për të ndihmuar bizneset e vogla duke vepruar si një arbitër i paanshëm.
- 3) Zyra jo vetëm që ndihmon në kryerjen e hetimit të pavarur dhe rikuperimit për çështjet që dalin nga prokurimi dhe për zgjidhjen e çështjeve në mënyrë që furnitori të mos marrë avokat. Nga ana tjetër, zyra u mundëson furnitorëve të japin mendimet dhe opinionet e tyre për praktikën e prokurimit të departamenteve federale me qëllim përmirësimin e procesit të prokurimit publik në të ardhmen.